



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 15

Tiranë – E hënë, 8 shkurt 2016

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Kuvendit nr. 1/2016, datë 21.1.2016	Për rrëzimin e dekretit nr. 9377, datë 29.12.2015, të Presidentit të Republikës, “Për kthimin e ligjit nr. 133/2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”..... 1005
Vendim i Kuvendit nr. 2/2016, datë 28.1.2016	Për mosmiratimin e projektligjit “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9235, datë 29.7.2004, “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar”..... 1005
Vendim i Kuvendit nr. 3/2016, datë 28.1.2016	Për miratimin e përbërjes së Komisionit të Posaçëm për Reformën Zgjedhore..... 1005
Vendim i Kuvendit nr. 4/2016, datë 28.1.2016	Për zgjedhjen e zotit Klodion Shehu anëtar i Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare..... 1005
Rezolutë e Kuvendit datë 28.1.2016	Për nderimin dhe mirënjohjen e thellë nga Republika e Shqipërisë për figurën e Presidentit Ibrahim Rugova..... 1006
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 2, datë 29.1.2016	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr. 00-2014-(283), datë 22.5.2014 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë..... 1006
	Vendim (<i>i shkurtuar</i>) për shpalljen të zhdukur të shtetasit Saimir Hasanaj..... 1013



VENDIM
Nr. 1/2016

**PËR RRËZIMIN E DEKRETIT NR. 9377,
DATË 29.12.2015, TË PRESIDENTIT TË
REPUBLIKËS, “PËR KTHIMIN E LIGJIT
NR. 133/2015 “PËR TRAJTIMIN E
PRONËS DHE PËRFUNDIMIN E
PROCESIT TË KOMPENSIMIT TË
PRONAVE””**

Në mbështetje të nenit 85, pika 2, të Kushtetutës dhe të nenit 86 të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Rrëzimin e dekretit nr. 9377, datë 29.12.2015, të Presidentit të Republikës, “Për kthimin e ligjit nr. 133/2015, “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave””.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miruar në datën 21.1.2016

VENDIM
Nr. 2/2016

**PËR MOSMIRATIMIN E PROJEKTLIGJIT
“PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.
9235, DATË 29.7.2004, “PËR KTHIMIN
DHE KOMPENSIMIN E PRONËS”, TË
NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të neneve 78 e 83, pika 1, të Kushtetutës dhe të neneve 38, pika 6, e 55 të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Mosmiratimin e projektligjit “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9235, datë 29.7.2004, “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar”.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miruar në datën 28.1.2016

VENDIM
Nr. 3/2016

**PËR MIRATIMIN E PËRBËRJES SË
KOMISIONIT TË POSAÇËM PËR
REFORMËN ZGJEDHORE**

Në mbështetje të nenit 77, pika 1, të Kushtetutës dhe të nenit 24 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e kryetarëve të grupeve parlamentare,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratohet përbërja e Komisionit të Posaçëm për Reformën Zgjedhore si më poshtë:

- | | | |
|--------------------|------|------------------|
| 1. Bashkim Fino | PS | (bashkëkryetar); |
| 2. Oerd Bylykbashi | PD | (bashkëkryetar); |
| 3. Vasilika Hysi | PS | (anëtar); |
| 4. Ulsi Manja | PS | (anëtar); |
| 5. Petrit Vasili | LSI | (anëtar); |
| 6. Shpëtim Idrizi | PDIU | (anëtar); |
| 7. Arben Ristani | PD | (anëtar); |
| 8. Eduard Halimi | PD | (anëtar); |
| 9. Gent Strazimiri | PD | (anëtar); |
| 10. Fatmir Mediu | PR | (anëtar). |

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miruar në datën 28.1.2016

VENDIM
Nr. 4/2016

**PËR ZGJEDHJEN E ZOTIT KLODION
SHEHU ANËTAR I BORDIT TË
AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES
FINANCIARE**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, neneve 4, 5 dhe 6 të ligjit nr. 9572, datë 3.7.2006, “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, të ndryshuar, dhe nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë,



KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Klodion Shehu zgjidhet anëtar i Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miraturar në datën 28.1.2016

**REZOLUTË
PËR NDERIMIN DHE MIRËNJOHJEN
E THELLË NGA REPUBLIKA E
SHQIPËRISË PËR FIGURËN E
PRESIDENTIT IBRAHIM RUGOVA**

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë:

- Duke mbajtur në konsideratë rëndësinë madhore të shtetit të Kosovës në mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve dhe për stabilitetin e rajonit të Ballkanit;

- Në nderim të thellë e me mirënjohje të rolit të jashtëzakonshëm e udhëheqës të Presidentit Ibrahim Rugova në rrugëtimin e shqiptarëve drejt shtetit të pavarur të Kosovës;

- Duke vlerësuar lart punën intelektuale dhe aktivitetin politik dhe shtetëror të Presidentit Ibrahim Rugova;

- Duke riafirmuar mbështetjen e plotë për rrugëtimin evropian dhe euroatlantik të Republikës së Kosovës, si dhe duke vlerësuar mbështetjen e partnerëve ndërkombëtarë në këtë proces;

- Duke përqaftuar trashëgiminë e veprës së tij si thelbësore për konsolidimin e shtetit të pavarur të Kosovës;

- Duke çmuar kontributin, vlerat dhe sakrificat e popullit të Kosovës, si dhe të patriotëve të shquar saj;

1. Nderon me mirënjohje të thellë kombëtare dhe me krenari patriotike punën intelektuale, politike dhe shtetërore të Presidentit Ibrahim Rugova.

2. Mbështet nismën për vendosjen e shtatores së Presidentit Rugova në një nga sheshet kryesore të qytetit të Tiranës dhe i sugjeron Bashkisë së Tiranës të finalizojë këtë nismë.

Miraturar në datën 28.1.2016

KRYETARI
Ilir Meta

**VENDIM
Nr. 2, datë 29.1.2016**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datat 26.6.2015, 15.9.2015, 30.9.2015 dhe 15.10.2015 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 31/2 Akti, që i përket:

KËRKUESE: Kimete Hasa

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Vera Serjanaj, Lumturi Seferkollu, Përparim Seferkollu, Fatbardha Daja, Enti i Banesave Durrës, Agjencia e Kthimit dhe e Kompensimit të Pronave

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimit nr. 00-2014-(283), datë 22.5.2014 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f dhe 134/1/g, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Gani Dizdari, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuases, e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuësja është një nga trashëgimtarët e trashëgimlënësit Seit Hasa.

2. Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Durrës, me vendimin nr. 708, datë 5.12.1994, ka vendosur: “T’i njohë pronësinë zotit



Seit Hasa mbi një truall me sipërfaqe 1018.5 m², të ndodhur në Varosh të Durrësit. Mbi këtë truall ndodhen të ngritura 2 baraka shtetërore që zënë truallin e për rrjedhojë trualli konsiderohet i zënë dhe i kompensohet sipas nenit 16, pika "b" të ligjit nr. 7698, datë 15.04.1993."

3. Mbi bazë të kontratave të shitblerjes datë 11.1.1994, me blerës Ismail Sulejmani; datë 24.11.1993, me blerës Antigoni Vllahu; datë 11.10.1993, me blerës Teki e Barije Seferkollit; datë 28.9.1993, me blerës Sabri Sulejmani e Shpresa Sulejmani; datë 24.2.1994, me blerës Astrit Lama e Vojsava Lama; datë 4.7.1996, me blerës Taze Kreshpaj dhe Artan Musaraj, rezulton se ndërtesat nr. 262 dhe nr. 263, të ngritura mbi truallin me sipërfaqe 1018.5 m², janë privatizuar nga personat e mësipërm si rrjedhojë e aktit të shitjes së kryer nga Enti i Banesave Durrës.

4. Kërkuesja i është drejtuar gjykatës me padi për të ndryshuar vendimin nr. 708, datë 15.12.1994, të KKP-së Durrës, me qëllim kthimin e lirë të truallit dhe konstatimin e pavlefshmërisë së kontratave të shitjes së truallit nga Enti i Banesave.

5. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. 1527, datë 6.10.1997, ka vendosur: *"Pranimin e kërkesëpadisë së paditëses Kimete Hasa, duke anuluar vendimin e KKKP-së për ish-pronarët pranë Bashkisë Durrës nr. 708, datë 5.12.1994, që ka vendosur të kompensojë sipërfaqen e truallit prej 1018.5 m², të ndodhur në lagjen Varosh Durrës, duke e detyruar KKKP-në Durrës ta kthejë në natyrë këtë sipërfaqe truall. Konstatimin e pavlefshmërisë të kontratave të shitjeve ndërmjet të paditurit Enti i Banesave Durrës e të paditurve të tjerë, detyrimin e këtyre të fundit për t'i njohur pronarë trashëgimtarët e Seit Hasës dhe detyrimin e të paditurve të njohin paditësit pronarë mbi sipërfaqen objekt gjykimi"*.

6. Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 377, datë 8.9.2005, ka vendosur: *"Prishjen e vendimit nr. 1527, datë 31.10.1997 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës për sa i përket të paditurit Teki Seferkollit dhe kthimin e çështjes për rigjykim në po atë gjykatë, por me tjetër trup gjyqësor. Lënien në fuqi të këtij vendimi për pjesët e tjera të tij"*.

7. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. 965, datë 31.3.2008, ka vendosur: *"Pranimin e kërkesëpadisë së paditëses Kimete Hasa, duke e konstatuar të pavlefshme kontratën e privatizimit të datës 11.10.1993, të regjistruar në regjistrin hipotekor me nr. 4574, datë 15.10.1993, lidhur ndërmjet palëve: Enti i Banesave Durrës dhe Teki Seferkollit, duke*

detyruar të paditurit dhe personin e tretë të njohin trashëgimtarët e Seit Hasës pronarë të sipërfaqes së truallit prej 1018.5 m²".

8. Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 10-2009-1094 (527), datë 22.12.2009, ka vendosur: *"Pranimin e kërkesëpadisë së paditëses Kimete Hasa. Konstatimin e pavlefshmërisë së kontratës së privatizimit të datës 11.10.1993, të regjistruar në regjistrin hipotekor nr. 4574, datë 15.10.1993, lidhur ndërmjet palëve: Enti i Banesave Durrës dhe Teki Seferkollit (trashëgimlënësi i të paditurve Vera Serjanaj, Lumturie Seferkollit e Përparim Seferkollit dhe personi i tretë Fatbardha Daja (Seferkollit), duke detyruar të paditurit dhe personin e tretë të njohin trashëgimtarët e Seit Hasës pronarë të sipërfaqes së truallit me sipërfaqe 1018,5 m²".*

9. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2014-(283), datë 22.5.2014, ka vendosur: *"Prishjen e vendimit nr. 10-2009-1094 (527), datë 22.12.2009 të Gjykatës së Apelit Durrës dhe të vendimit nr. 965, datë 31.3.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe pushimin e gjykimit të çështjes"*.

II

10. **Kërkuesja** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata), duke pretenduar se ndaj saj është zhvilluar një proces i parregullt ligjor gjatë gjykimit në Gjykatën e Lartë. Më konkretisht, ajo ka parashtruar se:

10.1 Është cenuar parimi i gjykatës së caktuar me ligj, pasi Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë e ka shqyrtuar çështjen në themel, duke rivlerësuar provat e marra nga gjykatat dhe duke vendosur në kundërshtim me to.

10.2 Është cenuar parimi i sigurisë juridike, pasi Gjykata e Lartë ka dhënë dy vendime të ndryshme për të njëjtën çështje. Një veprim i tillë pas një periudhe të gjatë nga marrja formë të prerë të vendimit, është cenim i parimit të sigurisë juridike. Me qëndrimin ndaj fitimit të pronësisë të mbajtur në vendimin që kundërshtohet, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka cenuar parimin e sigurisë juridike në lidhje me pronën e fituar kohë më parë.

10.3 Është cenuar e drejta e aksesit në gjykatë, pasi me vendimin e Kolegjit Civil kërkueses nuk i lihet asnjë mundësi të kundërshtojë vendimet e KKP-së në rrugë gjyqësore.



III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkujes

11. Gjykata vlerëson se kërkuësja legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës, dhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur në Gjykatën Kushtetuese brenda afatit të parashikuar nga ligji. Në kuptim të nenit 30, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e të drejtave të tij, individit mund të paraqesë kërkesë në Gjykatën Kushtetuese brenda 2 vjetëve nga data e njoftimit të vendimit të fundit të organit përkatës shtetëror. Në rastin në shqyrtim, Gjykata vëren se objekti i kërkesës është vendimi nr. 00-2014-(283), datë 22.5.2014 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë. Në këto kushte, Gjykata konstaton se kërkuësi e ka paraqitur kërkesën brenda afatit ligjor.

12. Për sa i përket legjitimitimit *ratione materiae*, në kuptim të nenit 131/f të Kushtetutës, individit mund t’i drejtohet Gjykatës për pretendime që lidhen me cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e kësaj të drejte. Gjykata ka theksuar se juridiksioni kushtetues bëhet i mundur kur kërkuësi shteron mjetet e ankimit pranë gjykatave të sistemit gjyqësor, çka nënkupton se kërkuësi duhet t’i shfrytëzojë në shkallët e sistemit gjyqësor të gjitha mjetet e lejueshme dhe mundësitë procedurale për vendosjen në vend të së drejtës së pretenduar. Mjetet ligjore konsiderohen të shteruara kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimin nr. 17, datë 24.3.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Në rastin në shqyrtim, Gjykata konstaton se kërkuësja nuk ka në dispozicion mjet tjetër për të kundërshtuar vendimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë. Për këtë arsye, ajo legjitimohet t’i drejtohet me kërkesë kësaj Gjykate.

B. Për pretendimin e cenimit të parimit të gjykatës së caktuar me ligj dhe së drejtës së aksesit në gjykatë

13. Kërkuësja ka pretenduar se është cenuar parimi i gjykatës së caktuar me ligj, pasi Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë e ka shqyrtuar çështjen

në themel dhe ka bërë vlerësim të ndryshëm të provave të marra nga gjykatat e shkallëve më të ulëta, në tejkalim të kufijve të shqyrtimit të çështjes.

14. Gjykata ka vlerësuar se një nga elementet e procesit të rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, është dhe shqyrtimi i çështjes nga një “*gjykatë e caktuar me ligj*”. Ky element karakterizohet, në sensin material, nga funksioni i saj gjyqësor, që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve nga organe të ngarkuara me ligj për të dhënë drejtësi. Përveç këtij kushti, këto organe duhet të shqyrtojnë dhe të vendosin mbi çështje që janë në kompetencë të tyre gjatë një procesi të zhvilluar mbi një procedurë ligjërishit të përcaktuar dhe në pajtim me rendin juridik. E drejta e çdo pale për t’u dëgjuar në seancë përpara një gjykate kompetente dhe të caktuar me ligj nënkupton që gjykata të ketë juridiksion për të gjykuar çështjen dhe që kompetenca për të vendosur për të t’i jetë njohur nëpërmjet ligjit (*shih vendimet nr. 40, datë 25.6.2015; nr. 2, datë 22.1.2014; nr. 27, datë 24.6.2013; nr. 22, datë 22.7.2009; nr. 31, datë 1.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Sipas jurisprudencës kushtetuese procesi nuk konsiderohet i parregullt, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, kur Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, mbi të njëjtat prova e fakte të vlerësuara në gjykimet e mëparshme, vendos të prishë vendimet dhe zgjidh vetë çështjen, për shkak të zbatimit të gabuar të ligjit (*shih vendimet nr. 40, datë 25.6.2015; nr. 27, datë 24.6.2013; nr. 7, datë 9.3.2009 të Gjykatës Kushtetuese*). Në ushtrimin e funksionit të saj si gjykatë e ligjit, Gjykata e Lartë mund të vendosë për themelin e çështjes vetëm nëse mosmarrëveshja mund të zgjidhet në bazë të të njëjtave fakte dhe prova të vlerësuara nga gjyqtari i faktit dhe që përbëjnë bazën e vendimit në të cilin është bërë një interpretim i gabuar i ligjit. Kontrolli i saj duhet të fokusohet vetëm në drejtim të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë së vendimeve të ankimuara, pra mbi mënyrën e zbatimit të ligjit nga gjykatat më të ulëta. Gjykata e Lartë nuk mund të anashkalojë apo të lërë pa vlerë prova që janë shqyrtuar dhe vlerësuar nga gjykatat e faktit, si dhe nuk mund të pranojë prova të cilat nuk janë administruar në gjykimin në fakt. Gjykata thekson se kusht për dhënien nga Gjykata e Lartë të një vendimi mbi themelin



e çështjes, në kuptim të nenit 485 të KPC-së, është që jo vetëm të mos nevojitet administrimi i provave të reja, por edhe që provat e administruara të jenë shqyrtuar dhe vlerësuar në mënyrë të mjaftueshme nga gjyqtari i faktit (*shih vendimin nr. 40, datë 25.6.2015; nr. 27, datë 24.6.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Gjykata vlerëson gjithashtu se kompetenca e saj për shqyrtimin e çështjeve nuk bazohet mbi të njëjtat dispozita procedurale të cilave u referohen gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e apelit. Sipas nenit 472 të KPC-së, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka në kompetencë të shqyrtojë problemet që kanë të bëjnë me mosrespektimin ose zbatimin e gabuar të ligjit material e procedural, kurse neni 485 i KPC-së i ka dhënë të drejtë Kolegjit Civil apo Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë që, ndër të tjera, të vendosin prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe të lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, si dhe të ndryshojnë njëkohësisht vendimet e të dyja gjykatave më të ulëta (*shih vendimet nr. 40, datë 25.6.2015; nr. 27, datë 24.6.2013; nr. 7, datë 9.3.2009; nr. 31, datë 1.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Në çështjen në shqyrtim, Gjykata konstaton se objekti i gjykimit në themel ka qenë, ndër të tjera, pavlefshmëria e kontratës së privatizimit të lidhur nga Enti i Banesave Durrës, si i pabazuar në ligj e prova, si dhe detyrimi për njohjen pronarë të trashëgimtarëve të Seit Hasës. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës dhe Gjykata e Apelit Durrës kanë vendosur pranimin e kërtimeve të paditëses dhe detyrimin e të paditurve të njohin pronare kërkuosen. Ndërsa Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë i ka dhënë konfliktit një zgjidhje krejtësisht të kundërt, duke u bazuar vetëm në faktin se gjykatat e faktit kanë vendosur kryesisht për detyrimin e njohjes pronare të paditëses/kërkuoses, pasi kjo e fundit nuk ka paraqitur një kërkim të tillë. Sipas Kolegjit Civil “...nga analiza tërësore ka rezultuar se pala paditëse asnjëherë nuk ka kërkuar zgjidhjen e pasojave të pavlefshmërisë së veprimit juridik, siç mund të ishte kërkitimi për kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme... Në këto kushte, Kolegji çmon se kërkitimi i palës paditëse për pavlefshmërinë absolute të kontratës së privatizimit nuk është shoqëruar me kërkitimin për zgjidhjen e pasojave të ardhura nga veprimi juridik, duke mos u shprehur as në padi, as në çdo fazë të gjykimit, as me ndonjë mjet tjetër procedural.”

18. Nga sa më sipër, Gjykata vlerëson se vendimi i Kolegjit Civil nuk është në përputhje me kërkesat e një procesi të rregullt ligjor të zhvilluar para tij. Nga tërësia e përmbajtjes së kërkesëpadiisë dhe e të gjitha akteve të tjera të depozituara në dosjen gjyqësore, Gjykata vëren se kërkitimi përfundimtar i kërkuoses dhe i përfaqësuesit të saj është pavlefshmëria e kontratës së shitjes dhe kthimi i palëve në gjendjen e mëparshme. Për këtë arsye, arsyetimi i Kolegjit Civil se kërkuoesja nuk ka kërkuar kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme dhe se gjykatat e faktit kanë vepruar në kundërshtim me objektin e kërkuar nga palët, nuk është i bazuar.

19. Gjithashtu, Gjykata vlerëson se vendimi i Kolegjit Civil duke pushuar çështjen i ka mohuar kërkuoeses edhe të drejtën e aksesit në gjykatë dhe pasjes së një vendimi përfundimtar që do t'i jepte përgjigje për sa ajo kërkon. E drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila do t'i dëgjojë pretendimet e tyre dhe do të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Gjykata ka vlerësuar vazhdimisht se administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë, për t'i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Në këtë kuptim, ky standard përfshin të drejtën për gjykim, ku e drejta e aksesit, që është e drejta për të vënë në lëvizje gjykatën, për çështjet civile, përbën një aspekt të saj. E drejta e aksesit në një organ gjyqësor duhet të jetë një e drejtë që lidhet me themelin dhe jo një e drejtë e pastër formale. Aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal. Mohimi i së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj për pretendimet e ngritura, përbën cenim të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 22, datë 16.4.2014; nr. 7, datë 27.2.2013; nr. 14, datë 26.3.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Bazuar në standardet e mësipërme kushtetuese, Gjykata vlerëson se në rastin konkret, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë nuk ka vepruar brenda kompetencave të tij ligjore, duke cenuar parimin e gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj dhe të drejtën e aksesit në gjykatë, si elemente të së drejtës për një proces të rregullt



ligjor. Për rrjedhojë, pretendimet e kërkuases në këtë drejtim janë të bazuara dhe duhen pranuar.

C. Për pretendimin e cenimit të parimit të sigurisë juridike

21. Kërkuësja ka pretenduar se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë me vendimin e tij ka cenuar parimin e sigurisë juridike, pasi ai Kolegji ka dhënë dy vendime të ndryshme për të njëjtën çështje. Një veprim i tillë pas një periudhe të gjatë nga marrja formë të prerë të vendimit përbën cenim të parimit të sigurisë juridike.

22. Gjykata konstaton se konflikti objekt gjykimi ka filluar të shqyrtohet nga gjykatat që në vitin 1995. Pas disa gjykimeve dhe rigjykimëve, me vendimin nr. 1527, datë 1997, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës është vendosur: *“Pranimi i kërkesëpadisë së Kimete Hasës, duke anuluar vendimin e KKP-së Durrës. Konstatimi i pavlefshmërisë së kontratave të shitjes mes të paditurit Enti i Banesave dhe të paditurve Taze Kreshpaj etj.”* Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 377, datë 8.9.2005, ka vendosur *“Prishjen e vendimit civil për një nga të paditurit, Teki Seferkollli, dhe lënien në fuqi për pjesët e tjera.”*

23. Kolegji Civil mbi rekursin e Entit të Banesave ka vendosur mospranimin e tij. Pas përfundimit të këtij gjykimi ka vazhduar të gjykohet pjesa e veçuar e padisë, e cila është gjykuar në favor të paditësve me vendimin nr. 965, datë 31.3.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, i cili është lënë në fuqi me vendimin nr. 527, datë 22.12.2009 të Gjykatës së Apelit Durrës. Ky vendim është prishur nga Kolegji Civil, tashmë objekt kundërshtimi para Gjykatës Kushtetuese. Pra, në gjykimin e parë për të njëjtin objekt padie, pavarësisht se gjykimi u nda për shkak të zëvendësimit procedural (vdekjes së njërit prej të paditurve), Kolegji Civil e konsideroi të bazuar padinë e kërkuases, ndërsa në gjykimin e dytë për të njëjtin objekt padie, vendosi shfuqizimin e vendimeve të gjykatave më të ulëta dhe pushimin e çështjes.

24. Gjykata rithekson se dhënia e vendimeve të ndryshme gjyqësore për çështje të njëjta bie ndesh me parimin e sigurisë juridike në praktikën e gjyqësore. Parimi i sigurisë juridike nënkupton, ndërmjet të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit të shteti, institucionet e tij dhe tek aktet që ato nxjerrin. Ndërsa, në rastin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, siguria

juridike nënkupton që gjykata ka vendosur përfundimisht për një çështje, vendimi i saj nuk duhet të vihet në dyshim. Pra, kur vendimi ka marrë formë të prerë ai është i detyrueshëm për palët, trashëgimtarët e tyre, për personat që tërheqin të drejta nga palët, për gjykatën që ka dhënë vendimin dhe për të gjitha gjykatat dhe institucionet e tjera. Asnjë gjykatë nuk mundet të gjykojë sërish të njëjtën padë kundrejt të njëjtave palë. Vendimi gjyqësor i formës së prerë, që përbën gjë të gjykuar, është shprehje dhe konkretizim i së drejtës mbi marrëdhënien juridike dhe ka qëllim t'i japë jo vetëm qartësi, por edhe siguri kësaj marrëdhënieje (*shih vendimet nr. 21, datë 16.4.2015; nr. 24, datë 12.11.2008; nr. 23, datë 8.6.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Parimi i gjësë së gjykuar përfshin jo vetëm urdhërimet e dispozitivit të vendimit gjyqësor por edhe zbatimin e së drejtës të përcaktuar në pjesën përshkruese arsyetuese të vendimit, me kusht që ato të jenë kryer me qëllim dhënien e vendimit gjyqësor dhe t'u përkasin fakteve ose marrëdhënieve që kanë formuar objektin e gjykimit mbi të cilin gjykata ka dhënë vendimin e saj (*shih vendimin nr. 36, datë 25.7.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur dhe Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, e cila ka nënvizuar se “... në pikëpamjen e Gjykatës, parimi në bazë të të cilit një vendim përfundimtar i formës së prerë është gjë e gjykuar dhe zgjidh mosmarrëveshjen midis palëve me një efekt përfundimtar është një element themelor i së drejtës për një gjykim të drejtë, që garantohet nga neni 6 i Konventës në çështjet civile. Parimi i sigurisë juridike dikton që kur një mosmarrëveshje civile është shqyrtuar në themel nga gjykata, vendimi i saj nuk vihet më në diskutim” (*shih çështjen Kehaya dhe të tjerë kundër Bullgarisë, datë 12.1.2006*). GJEDNJ-ja, në disa çështje kundër Shqipërisë (*shih Ramadhi dhe të tjerë kundër Shqipërisë, datë 13.11.2007; Hamzëraj kundër Shqipërisë, datë 3.2.2009; Manushaqe Puto dhe të tjerë kundër Shqipërisë, datë 31.7.2012*), ka evidentuar rëndësinë e sigurisë juridike në procesin e kthimit dhe të kompensimit të pronave, veçanërisht për sa u përket të drejtave të fituara nga vendimet që kanë njohur të drejta pronësie dhe të ruajtjes së garancive që lidhen me këto të drejta.

27. Në rastin konkret Gjykata konstaton se dhënia e dy vendimeve të ndryshme për të njëjtën



çështje nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka cenuar parimin e sigurisë juridike në vendimet gjyqësore, duke krijuar një situatë të paqëndrueshme dhe të paqartë ligjore për sa u takon pretendimeve të kërkuases.

28. Përveç sa më sipër, Gjykata vlerëson se Kolegji Civil duke pushuar çështjen ka lënë pa zgjidhje përfundimtare dhe në një situatë të pasigurt juridike kërkuases, e cila pas më shumë se 20 vjetëve në konflikte gjyqësore, nuk ka ende një vendim gjyqësor të formës së prerë që u jep zgjidhje përfundimtare pretendimeve të saj lidhur me të drejtën e pronës.

29. Për këto arsye, Gjykata vlerëson se edhe ky pretendim i kërkuases është i bazuar dhe duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1, shkronja “g”, të Kushtetutës, si dhe të nenit 72, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës.
- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr. 00-2014-(283), datë 22.5.2014 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.
- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Besnik Imeraj, Fatmir Hoxha, Vitore Tusha, Gani Dizdari, Fatos Lulo

MENDIM PARALEL

1. Kërkesja Kimete Hasa i është drejtuar Gjykatës duke pretenduar se vendimi nr. 00-2014-(283), datë 22.5.2014 i Gjykatës së Lartë, duke vendosur prishjen e vendimeve të gjykatave të faktit dhe pushimin e gjykimit të çështjes, i ka cenuar asaj të drejtën e aksesit në gjykatë, parimin e gjykatës së caktuar me ligj dhe parimin e sigurisë juridike.

2. Në qëndrimin përfundimtar, ndonëse pajtohem me vendimin e shumicës për shfuqizimin

si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit të lartpërmendur të Gjykatës së Lartë, cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj e shoh edhe nën një këndvështrim tjetër.

3. Parimi i gjykatës së caktuar me ligj është trajtuar gjerësisht në jurisprudencën e Gjykatës. Lidhur me vlerësimin e provave nga Gjykata e Lartë, sikurse thekson edhe shumica në vendimin e saj (*shih paragrafin nr. 15 të vendimit*), kjo e fundit jo vetëm nuk ka kompetencën të administrojë prova të reja, por, gjithashtu, nuk mund të vlerësojë ndryshe provat e vlerësuara nga gjykatat e faktit, si dhe nuk mund të anashkalojë ekzistencën e fakteve dhe të rrethanave që janë vërtetuar në gjykimin e faktit apo t’i ndryshojë ato (*shih vendimet nr. 53, datë 20.7.2015; nr. 40, datë 25.6.2015; nr. 27, datë 24.6.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

4. Konkretisht, sipas jurisprudencës kushtetuese, parimi i gjykatës së caktuar me ligj konsiderohet i cenuar, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, kur Kolegji i Gjykatës së Lartë, mbi të njëjtat prova e fakte të vlerësuara në gjykimet e mëparshme, vendos të prishë vendimet dhe ta zgjidhë vetë çështjen, për shkak të zbatimit të gabuar të ligjit (*shih vendimet nr. 27, datë 24.6.2013 dhe nr. 7, datë 9.3.2009 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata është shprehur se në ushtrimin e funksionit të saj si gjykatë e ligjit, Gjykata e Lartë mund të vendosë për themelin e çështjes vetëm nëse mosmarrëveshja mund të zgjidhet në bazë të të njëjtave fakte e prova të vlerësuara nga gjyqtari i faktit dhe që përbëjnë bazën e vendimit në të cilin është bërë një interpretim i gabuar i ligjit. Kontrolli i saj duhet të fokusohet vetëm në drejtësi të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë së vendimeve të ankmuara, pra mbi mënyrën e zbatimit të ligjit nga gjykatat më të ulëta. Gjykata e Lartë nuk mund të anashkalojë apo të lërë pa vlerë prova që janë shqyrtuar dhe vlerësuar nga gjykatat e faktit, si dhe nuk mund të pranojë prova të cilat nuk janë administruar në gjykimin në fakt (*shih vendimin nr. 32, datë 25.5.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

5. Gjithashtu, Gjykata ka vlerësuar se Gjykata e Lartë nuk mund të konkludojë *a priori* nëse është vërtetuar apo jo një fakt i caktuar. Në rast se Gjykata e Lartë vlerëson se provat e administruara nuk janë të mjaftueshme për arritjen e një konkluzioni apo se nevojitet kryerja e vlerësimeve të mëtejshme të tyre, ajo nuk mund të marrë kompetencat e gjykatës të faktit, pasi një veprim i



tillë bie ndesh me parimin e gjykatës së caktuar me ligj, por duhet ta kthejë çështjen për rishqyrtim, me qëllim plotësimin e këtyre të metave të vendimit. Nëse Kolegji i Gjykatës së Lartë ka arritur në një përfundim të ndryshëm nga gjykatat e faktit, atëherë ai duhet t'i prishë të dyja vendimet gjyqësore dhe ta kthejë çështjen për rigjykim (*shih vendimin nr. 32, datë 25.5.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

6. Në çështjen në shqyrtim shumica ka arritur në përfundimin se arsyetimi i Kolegjit Civil se kërkuesja nuk ka kërkuar kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme dhe se gjykatat e faktit kanë vepruar në kundërshtim me objektin e kërkuar nga palët, nuk është i bazuar (shih paragrafin nr. 18 të vendimit). Pajtohem me vendimin e shumicës se për këtë arsye Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë nuk ka vepruar brenda kompetencave të tij ligjore, duke cenuar parimin e gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj, por në ndryshim nga shumica, mendoj se ky parim duhet trajtuar edhe më gjerë. Në rastin në fjalë, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në dhomë këshillimi, ka vendosur "*Prishjen e vendimit nr. 10-2009-1094 (527), datë 22.12.2009 të Gjykatës së Apelit Durrës dhe të vendimit nr. 965, datë 31.3.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe pushimin e gjykimit të çështjes*".

7. Kompetencat e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë janë të parashikuara në nenin 485 të KPC-së. Sipas përcaktimeve të këtij neni, një prej mënyrave të përfundimit të çështjes, pas shqyrtimit të saj nga Kolegji Civil, është prishja e vendimeve dhe pushimi i gjykimit të çështjes (neni 485/e i KPC-së). Por edhe pse *pushimi i gjykimit të çështjes* hyn në kompetencat e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, jam i mendimit se neni 485/e i KPC-së është një dispozitë referuese. Në KPC rastet kur vendoset pushimi i gjykimit të çështjes nga gjykata parashikohen në nenin 299 të tij¹. Pikërisht këtyre rasteve duhet t'u referohen gjykatat kur çmojnë se duhet vendosur pushimi i gjykimit.

8. Nga interpretimi literal i nenit 299 të KPC-së vihet re se ligjvënësi nuk i ka përcaktuar në mënyrë shteruese rastet e pushimit të çështjes. Konkretisht,

neni 299/c i KPC-së, si një ndër këto raste, citon kur "*pushimi i gjykimit parashikohet shprehimisht në ligj*", duke i lënë mundësi vetes që të parashikojë me ligj edhe raste të tjera kur shihet e nevojshme. Përveç nenit 468 të këtij Kodi (sipas të cilit Gjykata e Apelit kur konstaton se çështja nuk hyn në juridiksionin gjyqësor, si dhe kur padia nuk mund të ngrihej ose gjykimi nuk mund të vazhdonte, prish vendimin edhe vendos vetë pushimin e gjykimit të çështjes), KPC-ja nuk parashikon asnjë rast tjetër që të justifikojë pushimin e gjykimit të çështjes nga gjykata, cilado qoftë ajo.

9. Nga sa më lart, sipas pikëpamjes sime e drejta që i njihet Gjykatës së Lartë në nenin 485/e të KPC-së për të vendosur prishjen e vendimeve dhe pushimin e gjykimit të çështjes nuk është e pakufizuar. Kjo gjykatë është e detyruar t'u përmbahet kufizimeve të vendosura nga ligjvënësi në nenin 299 të KPC-së. Çdo qëndrim i kundërt është arbitrar dhe cenon parimin e gjykatës së caktuar me ligj. Përkundrazi, në rastin në shqyrtim, Gjykata e Lartë edhe pse ka vendosur pushimin e gjykimit, nuk i është referuar asnjë prej rasteve të parashikuara në nenin 299 të KPC-së apo ndonjë rasti tjetër të parashikuara shprehimisht në KPC apo ligj.

10. Edhe Kodi i Procedurës Civile italiane përmban një parashikim të ngjashëm. Instituti i pushimit të gjykimit përcaktohet fillimisht nga nenet 306 dhe 307 të tij. Ndërsa për gjykimin në Gjykatën e Kasacionit, nenet 383 dhe 384 të KPC-së, që parashikojnë mënyrën e përfundimit të gjykimit pas shqyrtimit të çështjes, nuk citojnë pushimin e gjykimit. I vetmi parashikim gjendet në nenin 391 të KPC-së, sipas të cilit Gjykata e Kasacionit mund të vendosë pushimin e gjykimit "*në rastet e parashikuara në ligj*".

11. Si përfundim, mendoj se vendimi i Kolegjit Civil i Gjykatës së Lartë përveç parimeve të evidentuara nga shumica i ka cenuar kërkueses të drejtën për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosrespektimit të parimit të gjykatës së caktuar me ligj për shkak të pushimit të çështjes në shkelje të nenit 299 të KPC-së.

Anëtar: Vladimir Kristo

¹ Gjykata vendos pushimin e gjykimit kur:

a) asnjëra prej palëve nuk kërkon brenda gjashtë muajve rifillimin e gjykimit të pezulluar me kërkesën e tyre, kur gjykata nuk ka caktuar në vendimin e pezullimit një seancë të ardhshme;

b) paditësi heq dorë nga gjykimi i padisë;

c) pushimi i gjykimit parashikohet shprehimisht në ligj.



VENDIM

(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër, me vendimin nr. 373 (1261-33-2015), datë 24.12.2015, vendosi shpalljen të zhdukur të shtetasit Saimir Sabri

Hasanaj, i datëlindjes 1.6.1978, lindur në fshatin Zall-Reç të rrethit Dibër dhe banues në qytetin e Peshkopisë, qarku Dibër, duke caktuar si kujdestar të tij shtetasin Sabri Hasanaj.

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2016

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel: 042427005, 04 2427006

Çmimi 84 lekë